



Nga vetëdijësimi në Veprim

*- Si të mësuarit e personalizuar në kuadër të
nismës “CHAVORE” po i transformon
marrëdhëniet në mjediset e edukimit në fëmijëri
të hershme*

Gusht, 2025

Artikulli 1: Nga Vetëdijësimi në Veprim

-Si të mësuarit e personalizuar në kuadër të nismës “CHAVORE” po i transformon marrëdhëniet në mjediset e edukimit në fëmijëri të hershme

Nisma “CHAVORE”: “Mirëqenia mendore e fëmijëve të vegjël romë”, e financuar nga Programi i Komisionit Evropian për Qytetarë, Barazi, të Drejta dhe Vlera (CERV), vepron në mbarë Evropën për të promovuar shëndetin mendor dhe mirëqenien e fëmijëve të vegjël, veçanërisht atyre nga komunitetet e cënueshme, si familjet rome. Duke i mbështetur profesionistët e edukimit në fëmijërinë e hershme dhe prindërit me trajnime që i përshtaten kontekstit kulturor, CHAVORE ndihmon në krijimin e mjediseve ku çdo fëmijë pranohet, dëgjohet dhe mbështetet që nga hapat e parë të zhvillimit të tij.



Në muajt e fundit, partnerët e konsorciumit kanë zhvilluar një program të të mësuarit të vetë-drejtuar, i cili si pikësynim i ka profesionistët e fëmijërisë së hershme që punojnë drejtpërdrejt me fëmijët e vegjël romë dhe familjet e tyre në mjedise të ndryshme. Ky program i pajis këta profesionistë me njohuri dhe mjete praktike për mbështetjen e mirëqenies së gjithëmbarshme të familjeve.

Shtatë modulet trajnuese të zhvilluara nga partnerët e projektit CHAVORE ilustronë se si kjo nismë po vihet në jetë në kontekste të ndryshme. Për shembull, modulet e përgatitura nga partnerët në Kroaci, Kosovë dhe Hungari, të cilat fokusohen



përkatësisht në **Ndihmën e Parë Psikologjike**, aftësitë për shprehjen dhe kuptimin e emocioneve dhe qëndrueshmërinë, si dhe përfshirjen dhe kujdesin për veten, theksojnë angazhimin e përbashkët se marrëdhëniet e ndjeshme mes të rriturve dhe fëmijëve janë thelbësore për mbështetjen e mirëqenies dhe zhvillimit të fëmijëve të vegjël.

Programi i të mësuarit të vetë-drejtuar bazohet thellësisht në praktikën reale, si dhe në hartëzimin e palëve pjesëmarrëse në këtë proces si profesionistët, prindërit dhe fëmijët e moshës 3–6 vjeç, për t'i hulumtuar nevojat dhe strategjitë e përballjes së tyre me sfidat. Profesionistët e fëmijërisë së hershme udhëzohen të reflektojnë mbi emocionet, pritshmëritë dhe bindjet kulturore, si dhe modelet e marrëdhënieve, duke ndërmarrë ndryshime që e mbështesin ndjenjën e sigurisë, besimit dhe përkatësisë tek fëmijët.

Mjetet e përdorura janë praktike dhe gjithëpërfshirëse: 📖 tregimi i historive, 🧩 lojërat e simuluar, 😊 mbikëqyrja, 🎯 ushtrimet reflektuese dhe 🧠 strategjitë vëzhguese. Me rëndësi të veçantë është fakti që secili partner e përshtat përvojën e të mësuarit me kontekstin e tij lokal. Para fillimit të fazës pilotuese, do të realizohet një fazë e verifikimit.

Së bashku, këto module trajnuese përfaqësojnë një hap nga vetëdijësimi drejt veprimit: ato i fuqizojnë profesionistët e fëmijërisë së hershme jo vetëm që t'i kuptojnë nevojat e fëmijëve nga grupet e cënueshme, por edhe t'u përgjigjen atyre me kujdes, kompetencë dhe qëllim të qartë.

CHAVORE (që do të thotë “fëmijë” në gjuhën rome) është një iniciativë që synon të përmirësojë shëndetin mendor dhe mirëqenien e fëmijëve të vegjël, veçanërisht atyre nga komunitetet e cënueshme, si familjet rome. Ajo promovon gjithëpërfshirjen dhe kujdesin për fëmijërinë e hershme, të ndërtuar me ndjeshmëri ndaj diversitetit kulturor, në pesë vende. E bazuar në ekspertizën e [International Step by Step Association](#) dhe iniciativës së saj [Romani Early Years Network \(REYN\) initiative](#), CHAVORE shfrytëzon një partneritet transnacional për të zhvilluar arsim dhe kujdes gjithëpërfshirës e të përgjegjshëm në fëmijërinë e hershme.

E financuar nga [European Commission](#), konsorciumi përbëhet nga anëtarët e ISSA-së, i udhëhequr nga [Educational Research Institute](#) (Slloveni), dhe përfshin [Open Academy Step by Step](#) (OASbS), [Partners Hungary Foundation](#) (PH), [Skola dokoran - Wide Open School](#) (SD), [Kosovo Education Center](#) (KEC), dhe [ISSAHub](#).

Mësoni më shumë në: chavore.reyn.eu



Funded by
the European Union



ROMANI
EARLY YEARS
NETWORK

CHAVORE PARTNERS

